



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:027175

Datë: 02.05.2019

Numri i dokumentit: 00341903

P.nr.79/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Nushe Kadrija – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit D. Sh.nga fshati . . . , Komuna e Gjakovës, për shkak të veprës penale të vjedhjes së shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuari sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakove-Departamenti i Përgjithshëm me numër PP/II.nr.1823/17, të datës 26.01.2018, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, me datë 02.05.2019, në prezencën e Prokurores së Shtetit Mone Sylja, si dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, dhe e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

D. SH., nga i ati O., e ëma I., e gjinisë K., data e lindjes . . . në fshatin . . . , Komuna e Gjakovës, ku edhe tani banon por ka edhe vendqëndrim edhe në Zvicër, i martuar, baba i 4 fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, punon në Zvicër, i gjendjes së mesme ekonomike, Rom-shtetas i Republikës së Kosovës, me numër personal . . .

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse nga data e pa vërtetuar e deri me datën 29.06.2017, në shtëpinë e tij në fshatin . . . , Komuna e Gjakovës, me qëllim që vetit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, me qëllim fitimi në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike në kundërshtim me dispozitat e nenit 61 të Ligjit për Energjinë të Republikës së Kosovës, nr.05/L-85, në atë mënyrë që jashtë njehsorit elektrik me nr. . . , pemës kabllos 4x25 mm, ka bërë lidhje direkte në rrjetin elektrik duke penguar kështu regjistrimin e energjisë së shpenzuar elektrike, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të Distriktit në Gjakovë, me rastin e kontrollës, me ç'rast të dëmtuarës K.-Distrikti në Gjakovë i ka shkaktuar dëm në shumë prej 393.47 Euro.

Me këto veprime ka kryer veprën penale të vjedhjes së shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 41, 38, 69, 70, 81, 82, dhe nenit 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

V Ë R E J T J E G J Y Q Ë S O R E

Të akuzuarit D. Sh., i bëhet me dije se ka kryer një veprë të dëmshme dhe të rrezikshme që përbën veprë penale dhe nëse ai sërish kryen veprë të tillë, gjykata do të shqiptojë sanksion më të rëndë penal.

E dëmtuara K.-Distrikti Gjakovë, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

Detyrohet i akuzuari, që ti paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 30 (tridhjetë) Euro, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 30 (tridhjetë) Euro të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë- Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.1823/17, të datës 26.01.2018, kundër të akuzuarit D. Sh.nga fshati . . ., Komuna e Gjakovës, ku fillimisht të akuzuarin e kishte akuzuar për shkak të veprës penale nga neni 61 par.1 nënpar.1.2 të Ligjit për Energjinë Elektrike të Republikës së Kosovës nr.05/L-85. Prokuroria Themelore në Gjakovë, përmes parashtresës së datës 08.03.2019, ka bërë përmirësimin e aktakuzës duke e bërë rikualifikimin e veprës penale nga neni 61 par.1 nënpar.1.2 të Ligjit për Energjinë Elektrike të Republikës së Kosovës nr.05/L-85 në veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së. Prokurorja e Shtetit Mone Sylja, gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se: bëjë rikualifikimin e veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, duke marrë parasysh se nga data 14.Prill.2019 ka hyrë në fuqi Kodi i Ri Penal , ashtu që duke aplikuar nenit 3 par.2 të KPRK-së, për zbatimin e ligjit më të favorshëm pasi që sipas nenit 320 të ish KPRK-së, për veprën penale për të cilën ngarkohet i akuzuari parashihet dënimi komulativ pra dënim me gjobë dhe me burgim deri në 3 vite, ndërsa sipas Kodit të Ri Penal, vepra penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, është e dënushme me dënim me gjobë ose me burgim në 3 (tri) vite, para dënushmris për këtë veprë është e përcaktuar në mënyrë alternative, dhe Kodi i Ri Penal dhe vepra penale vjedhje e shërbimeve neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, është më i favorshëm për të pandehurin, prandaj edhe bëjë rikualifikimin e veprës penale, vepra penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të ish KPRK-së (Kodi i vjetër) në veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, (Kodi i Ri Penal), ndërsa pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar. Prokurorja e shtetit, gjatë shqyrtimit fillestar ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës së rikualifikuar kundër të akuzuarit D. Sh.andaj, ka propozuar që i njëjti të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari D. Sh., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës dhe ka shtuar se është penduar për këtë veprim dhe i ka premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të këtilla.

Prokurorja e shtetit Mone Sylja, duke dhënë mendim rreth pranimin të fajësisë nga ana e të akuzuarit ka deklaruar se: nuk e kundërshtojë pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e bën me vetëdije dhe vullnet të plotë pa presion, i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë po ashtu pranimi i fajësisë mbështetet edhe provat dhe në faktet që janë bashkangjitur aktakuzës.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari D. Sh., nga data e pa vërtetuar e deri me datën 29.06.2017, në shtëpinë e tij në fshatin . . . , Komuna e Gjakovës, me qëllim që vetit ti sjellë përfitim pasuror të kundërligjshëm, me qëllim fitimi në mënyrë të paautorizuar ka shfrytëzuar energjinë elektrike në kundërshtim me dispozitat e nenit 61 të Ligjit për Energjinë të Republikës së Kosovës, nr.05/L-85, në atë mënyrë që jashtë njehsorit elektrik me nr. . . , përmes kabllor 4x25 mm, ka bërë lidhje direkte në rrjetin elektrik duke penguar kështu regjistrimin e energjisë së shpenzuar elektrike, gjendje kjo e konstatuar nga personat e autorizuar të Distriktit në Gjakovë, me rastin e kontrollës, me ç'rast të dëmtuarës K.-Distrikti në Gjakovë i ka shkaktuar dëm në shumë prej 393.47 Euro.

Gjykata gjendjen e këtyllë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimit i fajësisë nga e akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimit i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se e akuzuara ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimit është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimit i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekzistojnë asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së për hedhjen e aktakuzës përkatësisht pushimin e procedurës penale.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale të vjedhjes së shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin ta shpall fajtorë dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: se është baba i 4 fëmijëve, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, pendimin dhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të përsëritë veprime të këtylla si dhe faktin që më parë nuk ka qenë e dënuar. Ndërsa si rrethana posaçërisht lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimitin e fajësisë në shqyrtimin fillestar për veprën penale për të cilën ngarkohet. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese për të akuzuarin gjykata ka ardhur në përfundim se në rastin konkret duhet të aplikohet dispozitat e nenit 82 par.3 të KPRK-së dhe ka shqiptuar vërejtje gjyqësore, pasi që gjykata konsideron se edhe me anë të vërejtjes gjyqësore do të arrihet qëllimi i vërejtjes, që të akuzuarit ti jepet qortimi, e që në rastin konkret edhe vërejtja gjyqësore është sanksion i mjaftueshëm për të arritur qëllimin e dënimit dhe qëllimin e vërejtjes gjyqësor nga neni 38 dhe 81 të KPRK-së dhe se ky sanksion i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi udhëzimin e palës së dëmtuara për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest civil është marrë në kuptim të dispozitës së nenit 463 par.2 të KPP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është marr konform nenit 450 par.1 dhe 2 nënpar.2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPP-së, ndërsa për programin për kompensimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar.3.1 të Ligjit Nr.05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform neneve 498 par.1 dhe 2 dhe 499 par.1, 2, 3 lidhur me nenin 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.79/18, me datë 02.04.2019

Procesmbajtësja,
Nushe Kadrija

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mentor Bajraktari

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh pas marrjes së aktgjykimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate.